



Bachelor në “INFORMATIKË BIZNESI”

Program Bachelor në "Informatikë Biznesi"

Programi Bachelor në Informatikë Biznesi ofron një formim dhe kompetenca akademike të integruara të shkencave kompjuterike, administrimit të biznesit dhe shkencave ekonomike, me qëllim pajisjen e studentëve me aftësitë e nevojshme për të projektuar, zbatuar dhe menaxhuar sisteme informacioni që mbështesin funksionimin modern të bizneseve dhe organizatave. Ky program ndërdisiplinor i jep rëndësi si njohurive teorike, ashtu edhe zbatimit praktik, veçanërisht në fusha si zhvillimi i softuerëve, menaxhimit të të dhënave, sistemet e ndërmarrjeve dhe strategjitë e transformimit digjiital.

Objektivat e Programit

Ky program synon të:

- Të formojë specialistë të kualifikuar në fushat e programimit, teknologjisë së informacionit dhe menaxhimit, duke ofruar njohuri të thelluara në programim, konceptet ekonomike dhe menaxhimit, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave, rrjetet dhe sistemet e informacionit, si dhe zhvillimin e programeve kompjuterike dhe aplikacioneve web të përshtatura për biznese, organizata dhe institucione.
- Të përgatisë specialistë të aftë për të zhvilluar, menaxhuar dhe mirëmbajtur sisteme dhe aplikacione të ndryshme në përputhje me nevojat e bizneseve dhe entiteteve të tjera që operojnë në sistemin e agrobiznesit.
- Të zhvillojë tek specialistët e rinj aftësitë dhe cilësitë e nevojshme për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve në ndërmarrjet e sektorit të agrobiznesit, me fokus të veçantë në integrimin e tyre me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK).
- T'u ofrojë studentëve mjete dhe metoda për analizimin dhe interpretimin e të dhënave në funksion të planifikimit strategjik si edhe funksioneve të tjera menaxheriale veçanërisht në sistemin e agrobiznesit por edhe organizata dhe agjenci të sektorit publik të lidhura me to.
- Të përgatisë studentët për të zhvilluar, zbatuar dhe menaxhuar teknologji informacioni të përshtatura për sistemin e agrobiznesit, i cili mbështetet gjithnjë e më shumë në zgjidhje digjitale si sistemet e menaxhimit të zinxhirëve të furnizimit, logjistikën e shpërndarjes, bujqësinë precize, analizën dhe zhvillimin e produkteve të tregut.
- Të formojë profesionistë të rinj, të orientuar drejt funksionalizimit të dijeve në praktikë dhe rritjes së eficiencës të përdorimit të burimeve dhe veprimtarisë ekonomike në tërësi.

Kompetencat profesionale

- Të jenë të aftë të dizenojnë dhe të zhvillojnë sisteme për mbledhjen, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave të lidhura me sistemin e agrobiznesit.
- Të zhvillojnë zgjidhje digjitale për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, duke siguruar ndjekjen efikase të mallrave nga ferma deri te tregu, me fokus në nxitjen e inovacionit në sektorin e agrobiznesit.
- Të mund të krijojnë platforma për shitjen direkte të produkteve, duke përdorur mjete të marketingut digjital për të lidhur prodhuesit me tregje më të gjera të konsumatorëve.
- Të jenë të aftë të zhvillojnë sisteme të menaxhimit financiar, përfshirë mjetet për sigurimin dhe vlerësimin e rrezikut, të përshtatura për operacionet e agrobiznesit.
- Ndërtojnë sisteme që sigurojnë përputhshmërinë e aktiviteteve të agrobiznesit me rregulloret mjedisore, të sigurisë dhe të tregtisë.
- Të mund të mbrojnë të dhënat e ndjeshme të operatorëve dhe aktiviteteve të agrobiznesit përmes masave të sigurisë kibernetike, duke garantuar integritetin e informacionit operacional dhe të tregut.
- Të mund të aplikojnë mjete dhe metodologji analitike për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe planifikimin strategjik, me fokus të veçantë në agrobiznes dhe sektorët e lidhur me të.
- Të jenë të aftë të integrojnë teknologjitë e avancuara të informacionit në proceset e menaxhimit të biznesit, duke mundur vendimmarrje dhe veprimtari efikase dhe përmirësime digjitale operative në ekonomi dhe agrobiznes.

Ekspertët në teknologjinë e informacionit, sistemet e informacionit dhe programuesit me aftësi në analizën e të dhënave, zhvillimin e softuerit, cloud computing dhe Internetin e Gjërave (IoT) janë thelbësorë për nxitjen e inovacionit dhe për adresimin e sfidave të veçanta në industrinë e sistemit të agrobiznesit por edhe organizatat publike dhe agjencitë e lidhura me to.

Mundësitë e zhvillimit të karrierës

Tregut i punës ka gjithnjë e më shumë një kërkesë të fortë për profesione të lidhura me teknologjinë dhe informacionin, të nxitur nga digjitalizimi në rritje i bizneseve, bujqësisë, agroindustrisë dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë. Të diplomuarit në programin e Informatikës së Biznesit kanë një profil të gjerë profesional dhe janë të aftë të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm, duke ndërlidhur teknologjinë e informacionit me menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit. Disa prej mundësive kryesore të karrierës për të diplomuarit në programin e Informatikës së biznesit janë:

- Projektues i Sistemeve Inovative – Krijimi, dizenjimi, marketingu dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve digjitale inovative; programues dhe analistë sistemesh.
- Administrator i Bazave të të Dhënave & Analist të Dhënash – Menaxhimi dhe siguri i të dhënave organizative për performancë dhe besueshmëri; analizimi i të dhënave të biznesit dhe operacionale për të mbështetur vendimmarrjen dhe zhvillimin e strategjive.

- Menaxhim i Sistemeve të Informacionit dhe Cloud – Marrja e përgjegjësive kyçe në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të IT-së në fusha si logjistika dhe bankat; administratorë sistemesh ose rrjetesh.
- Analist i Biznesit në IT dhe Konsulencë – Lidhja midis nevojave të biznesit dhe zgjidhjeve teknologjike përmes modelimit të proceseve dhe kërkesave të sistemeve; optimizimi dhe mbështetja e proceseve të biznesit dhe avancimi i digjitalizimit në kompani.
- Zhvillues Sistemi / Inxhinier Softuerësh – Dizenjimi dhe implementimi i aplikacioneve softuerike të biznesit dhe sistemeve të ndërmarrjeve të agrobiznesit dhe më gjerë.
- Sisteme Biznesi dhe Financiare – Menaxhimi efektiv i IT-së brenda një kompanie dhe gjenerimi i treguesve kyç të performancës për produktivitetin dhe efikasitetin e IT-së; administrator i sistemeve ERP & CRM; zbatim i softuerëve financiarë.
- Specialist në E-Business ose E-Government – Zhvillimi dhe menaxhimi i platformave online dhe shër-bimeve digjitale në sektorin privat dhe publik; specialist në tregtinë elektronike, zhvillues dhe analist uebi.
- Sektori i IT-së & Programimit – Bazuar në idenë personale për një start-up, të diplomuarit mund të krijojnë me sukses kompani programimi dhe zgjidhjesh digjitale.

Struktura e programit

Programi i Informatikës së Biznesit është i strukturuar në tri vite akademike, ku secili vit kontribon në mënyrë progresive në zhvillimin e njohurive teorike të studentëve, kompetencave analitike dhe aftësive praktike.

- Viti1 - Bazat themelore

Viti i parë përfshin lëndë dhe kompetenca fundamentale, duke përfshirë; Matematikën dhe Matematikën e aplikuar, Probabilitetin, Ekonominë (Mikroekonomia I dhe Makroekonomia I). Hyrja në Informatikë mbulon konceptet themelore të shkencës kompjuterike dhe parimet e programimit. Algoritmet dhe Strukturat e të Dhënave fokusohen në ndërtimin e algoritmeve për organizimin dhe përpunimin e të dhënave. Gjithashtu, kurset e Gjuhëve të Huaja zhvillojnë aftësitë e komunikimit, modulet nga shkencat e jetës ofrojnë njohuri të prodhimit bujqësor dhe atij blegtoral, ndërsa Sociologjia shqyrton strukturat shoqërore.

- Viti2 - Zhvillimi dhe thellimi i njohurive

Viti i dytë përqendrohet në dije më të avancuara në fushën e biznesit dhe të programimit. Modulet përfshijnë Statistikën II- për analizë të thelluar të të dhënave, Financa- për marrjen e vendimeve financiare dhe Sistemet Operative- për kuptimin e funksioneve të sistemeve kompjuterike. Sistemet e Mbështetjes së Vendimeve mësojnë mjete për marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna, Menaxhimi i bazave të të dhënave përqendrohet në projektimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e tyre, ndërsa Programimi vazhdon me koncepte më të avancuara në zhvillimin e softuerëve. Menaxhimi i Fermës dhe Menaxhimi Operacional përqendrohen në operacionet bujqësore dhe ato të biznesit. Modulet të tjera, si Kontabiliteti, Sistemet e Informacionit të Biznesit dhe Marketingu, thellojnë njohuritë themelore në biznes dhe IT.

- Viti3 - Specializimi dhe praktika

Viti 3: përfshin përfshin thellimin e njohrive në dhe zhvillimin e aftësive praktike në fushën e informatikës së biznesit. Programi përfshin Ekonometrinë për analizën e të dhënave ekonomike, si dhe Modelimin e Biznesit për analizën e proceseve të biznesit. Aplikimet e Softuerëve dhe Programimi Web synojnë zhvillimin e aftësive praktike në programim. Sipërmarrja dhe Bizneset e Vogla përqendrohen në menaxhimin e biznesit, ndërsa ASP.Net, C# dhe Programimi me Python mbulojnë gjuhët kryesore të programimit. Menaxhimi i Karrierës përmirëson dhe zhvillon aftësitë profesionale, dhe Njohuria e Informacionit përqendrohet në menaxhimin efektiv të informacionit.

Qasja Ndërdisciplinore

Kurrikula e programit në Informatikë Biznesi është e strukturuar me kujdes, me 67% të lëndëve në fushën e informatikës, 28% në ekonomi dhe menaxhim, dhe 5% në lëndë të lidhura me bujqësinë, duke ofruar një program ndërdisciplinor. Shembujt praktikë dhe projektet janë të fokusuar në agrobiznes dhe agroindustri, duke siguruar që studentët të fitojnë njohuri të specializuara, të përshtatshme për këto sektorë.

Ky program përfaqëson një shembull të mënyrës se si arsimi modern mund të ndërtojë ura midis inovacionit teknologjik, parimeve tradicionale ekonomike dhe menaxhimin e biznesit. Ky program përfaqëson një model të profesioneve të reja dhe me një realitet kërkese dinamikash në rritje nga tregu i punës.

Pse të zgjidhni këtë program?

Në një treg pune gjithnjë e më të orientuar drejt transformimit digjital, bizneset kërkojnë profesionistë të aftë që zotërojnë njohuri të thelluara në zhvillimin dhe përdorimin strategjik të sistemeve të informacionit dhe komunikimit dhe njohurive të menaxhimit të bizneseve. Ky program, me një qasje të orientuar drejt praktikës, u ofron studentëve kompetencat e nevojshme për të shfrytëzuar teknologjitë moderne, menaxhimin efektiv të të dhënave dhe biznesit në vetvete si edhe zhvillimin e softuerëve, duke i vënë ato në funksion të përgatitjes së bizneseve për sfidat e së ardhmes digjitale.

Programi mbështetet në një strukturë të balancuar që përfshin planifikimin, projektimin, zhvillimin, zbatimin, funksionimin, optimizimin dhe përdorimin ekonomik të sistemeve të informacionit dhe komunikimit.

Nëpërmjet kombinimit të dijeve nga shkencat kompjuterike dhe administrimi i biznesit, si dhe shkencave ekonomike të diplomuarit e këtij programi janë të përgatitur të zbatojnë zgjidhje inovative në fushën e teknologjisë së informacionit, mbështesin proceset vendimmarrëse dhe të kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme në proceset e digjitalizimit të bizneseve me një fokus të veçantë në sektorët e financës, shërbimeve, agrobiznesit dhe agroindustrisë.

Ky program studimi dhe diploma që ofrohet përmes tij reflekton një realitet të ri dinamik, modern të zhvillimit të profesioneve dhe ekskluzivisht të kërkuar nga tregu i punës në dy dekadat e fundit.

Kurrikula e Studimeve

PROGRAMI I CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR NË “INFORMATIKË BIZNESI”

Viti I, Semestri I (1)						
Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim Individual	Total	
1	Matematikë	6	60	90	150	A
2	Bujqësi e Përgjithshme	6	60	90	150	A
3	Mikroekonomi	6	60	90	150	A
4	Makroekonomi	6	60	90	150	A
5	Hyrje në Informatikë	6	60	90	150	B
	Totali	30	300	450	750	

Viti I, Semestri II (2)						
Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim Individual	Total	
1	Matematikë e Zbatuar	6	60	90	150	B
2	Bazat e Menaxhimit të Mjedisit	6	60	90	150	D
3	Teoria e Probabilitetit	6	60	90	150	A
4	Algoritmikë dhe Strukturë të Dhënash	6				B
	Algoritmikë në Python	3	37	38	75	
	Strukturë të Dhënash	3	37	38	75	
<i>Modul me zgjedhje I</i>						
5.1	Anglishte Biznesi dhe Sociologji	6				D
	Anglishte Biznesi	4	45	55	100	
	Sociologji	2	30	20	50	
5.2	Anglishte Biznesi dhe e Drejtë Digjitale	6				D
	Anglishte Biznesi	4	45	55	100	
	Hyrje në të Drejtën Digjitale	2	30	20	50	
5.3	Anglishte Biznesi dhe Aftësi Kërkimore	6				D
	Anglishte Biznesi	4	45	55	100	
	Aftësi Kërkimore Digjitale	2	30	20	50	
	Totali	30	329	421	750	

Viti II, Semestri I (3)						
Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim Individual	Total	
1	Statistikë 1	6	60	90	150	A
2	Kontabilitet	6	60	90	150	C
3	Sisteme Kompjuterike dhe Rrjeta	6				B
	Arkitekture Kompjuteri dhe Rrjeta	3	30	45	75	
	Sisteme Operimi	3	45	30	75	
4	Programim Python	6	60	90	150	B
5	Database dhe Menaxhim	6	60	90	150	B
	Totali	30	315	435	750	

Viti II, Semestri II (4)						
Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategori a
			Në Auditor	Studim Individual	Total	
1	Statistikë Biznesi	6	60	90	150	B
2	Financë	6	60	90	150	C
3	Sistemet e Informacionit dhe Mbështetjes së Vendimmarrjes	6	60	90	150	B
4	Bujqësi Inteligjente	6				B
	Sistemet e Gjeoinformacionit	3	37	38	75	
	Aplikime të Bujqësisë Inteligjente	3	37	38	75	

Modul me zgjedhje II

5.1	Marketing dhe Menaxhim Agrobiznesi	6				C
	Marketing	3	37	38	75	
	Menaxhim Agrobiznesi	3	37	38	75	
5.2	Marketing dhe Menaxhim Operacional	6				C
	Marketing	3	37	38	75	
	Menaxhim Operacional	3	37	38	75	
	Totali	30	328	422	750	

Viti III, Semestri I (5)

Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual	Total	
1	Bazat e Ekonometrisë	6	60	90	150	B
2	Modelim Biznesi	6	60	90	150	B
3	Programimi i Orientuar në Objekte	6	60	90	150	B
4	Programim Web	6	60	90	150	B

Modul me zgjedhje III

5.1	Menaxhim Publik dhe Siguria e-Shërbimeve	6				B
	Menaxhim Publik dhe e-Shërbime	4	45	55	100	
	Bazat e Sigurisë	2	30	20	50	
5.2	Menaxhim Publik dhe Cloud Computing	6				B
	Menaxhim Publik dhe e-Shërbime	4	45	55	100	
	Cloud Computing	2	30	20	50	
	Totali	30	315	435	750	

Viti III, Semestri II (6)						
Nr.	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			Në Auditor	Studim individual/ Praktike Profesionale	Total	
1	Teknologjitë .NET	6	60	90	150	B
2	Hyrje në Inteligjencën Artificiale	6	60	90	150	B
<i>Modul me Zgjedhje V</i>						
3.1	Sipërmarrje dhe Taksim	6				C
	Sipërmarrje dhe Biznes i Vogël	3	37	38	75	
	Taksim	3	37	38	75	
3.2	Energji e Rinovueshme dhe Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike	6				C
	Ndryshimet Klimatike dhe Adaptimi i Ekosistemeve	3	37	38	75	
	Teknologjitë e Energjive të Rinovueshme	3	37	38	75	
5	Praktikë Profesionale	6		150	150	D
6	Teza Bachelor/ Provimi Përfundimtar	6	10	140	150	E
	Totali	30	204	546	750	
	Totali (1+2+3+4+5+6)	180	1791	2709	4500	